

Ligj
Nr. 105/2023, date 21.12.2023

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 92/2014,
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 56, të seksionit 2, të kreut VIII, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 40 pas togfjalëshit “për majmëri” shtohen fjalët “kafshëve të gjalla racëpastër, barrëse ose jobarrëse për riprodhim (speciet gjedhë, dhenë, dhi, derra dhe njëthundrakë), si dhe i materialit biologjik që përdoret për inseminimin artificial.

2. Pas pikës 46 shtohet pika 47 me këtë përmbajtje:

“47. Importimi i insekteve të dobishme, të cilat përfshihen në kodet 0106 41 00, 0106 49 00 dhe 0106 90 00, si dhe grackat e ndryshme përfshirë letrat ngjitëse dhe ferromonet, që përdoren kundër insekteve të dëmshme”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2024.

Miraturar në datën 21.12.2023.

Shpallur me dekretin nr. 4, datë 9.1.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

Botuar ne F.Zyrtare 8/2024

Dale nga shtypi me 12.01.2024